



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.Shk II.nr. 346/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” SH.A., me seli në Prishtinë, rruga “Thazir Shala”, nr.4, kundër debitorit “Shoqata e ish të Burgosurve Politike”, me seli në Prishtinë, rruga “Nazim Gafurri B0777” me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.577/23 të datës 19.09.2023, me datë 07.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” SH.A., ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.577/23 të datës 19.09.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.577/23 të datës 19.09.2023 në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Shoqata e ish të Burgosurve Politike”, dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.301/23 i datës 14.03.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, është shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.577/23 të datës 19.09.2023.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka kërkuar që të refuzohet ankesa e kreditorit si e pa bazuar ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.577/23 të datës 19.09.2023, të vërtetohet.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” SH.A., me dt. 13.03.2023, ka paraqitur propozim për në bazë të dokumentit të besueshëm Kartela Financiare e Konsumatorit dhe ka urdhëruar debitorin “Shoqata e ish të Burgosurve Politike”, që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimi të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 740.01 €, si dhe shpenzimet e përmbartimit sipas tarifës së përmbartuesve privat në pajtim me udhëzimin administrativ.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbartimit me arsyetimin se borxhi i kreditorit është i parashkruar në pajtim me dispozitat ligjore të LMD-së, që ka të bëjë me kërkesat periodike që është prej një viti nga data kur krijohet raporti juridiko-civil i obligimit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri përmbartimor P.nr.301/23 i datës 14.03.2023.

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pa bazuar dhe të pa argumentuar si dhe pa mbështetje në ligj dhe prova. Tutje ka shtuar se pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës nuk qëndrojnë për faktin se sipas dispozitave të nenit 368 të LMD-së, citohet se parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin dhe pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit veçse edhe në mënyrë të tërthortë sikurse janë pagesat e këstit, pagesa, dhënia e sigurimit. Më tutje ka shtuar se debitori e ka ndërprerë parashkrimin me pranimin e pagesave të pjeshme, po ashtu debitori ka bërë marrëveshje për riprogramimin e borxhit me datë 01.07.2021 me këste mujore deri në 24 muaj, ku debitori edhe e ka pranuar borxhin e tij andaj prapësimi i debitorit nuk mbështetet në ligj. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi në tërësi si i pabazuar dhe urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.301/23 i datës 14.03.2023, të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.577/23 të datës 19.09.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Shoqata e ish të Burgosurve Politike”, dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.301/23 i datës 14.03.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, është shfuqizuar.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se Kartela Financiare e Konsumatorit shifra 18, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit

dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është kërkuar përmbushja e borxhit nga debitorit.

Gjykata e Shkallës së Dytë me shikim nga shkresat e lëndës ka vërejtur se ë Kartela Financiare e Konsumatorit, me shifër nr.18, përmban borxhin në shumën prej prej 740.01 €, për periudhën 01.01.2013 deri me datë 09.03.2023, ndërsa në Kartelën Financiare të Konsumatorit, përfshihet periudha kohore prej datës 31.12.2013, mirëpo nuk është paraqitur periudha kohore për të cilën është krijuar ky borxh, përkatësisht nuk është e përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri më datë 31.12.2013, dhe nuk mund të vërtetohet se si ka ardhur deri tek borxhi i kërkuar.

Me dispozitën ligjore të nenit 27 të LPP-së, në mënyrë shprehimore është përcaktuar se *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përbarimor të papërshtatshëm për përbarim.

Andaj, gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por te njëjtat mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II nr.346/24 me datë 07.06.2024,**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami**